

EC
MA NDRYSHE

KROJET E PRIZRENIT

2023



Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe
Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren &
Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 No.7
www.ecmandryshe.org
info@ecmandryshe.org
029 222 771 & 038 224 967

Ky hulumtim është realizuar nga EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit “Zbatimi i programeve të strategjisë të EC” i përkrahur nga programi i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) ‘EJA Kosovë’, bashkëfinancuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida).

Përmbajtja dhe qëndrimet e paraqitura këtu nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtarë të donatorëve.



LUXEMBOURG
AID & DEVELOPMENT



Përmbajtja:

— HYRJE

01 — Krojet nën mbrojtje institucionale

1.1 — Kroi i Shatërvanit

1.2 — Kroi i Xhamisë së Sinan Pashës

1.3 — Kroi i Esmë Hanëmit

1.4 — Kroi i Qorr agës "Haxhi Ramadanit"

1.5 — Kroi i Binbashit

1.6 — Kroi i Destan Kabashit

1.7 — Kroi i Familjes Perolli

1.8 — Kroi Topokli (6 krojet)

1.9 — Kroi i Beledijes

1.10 — Krojet e Teqes së Tarikatit Halveti

1.11 — Krojet e Xhamisë së Gazi Mehmet Pashës

02 — Krojet familjare

2.1 — Kroi në shtëpinë e Abdyl Perollit

2.2 — Kroi në shtëpinë e Haxhi Fahrisë

2.3 — Kroi në shtëpinë e Abdullah Pomakut – Caka

2.4 — Kroi në shtëpinë e Sinjave

2.5 — Kroi në shtëpinë e Haxhi Rrustem Shportës

03 — Krojet e humbura

2.1 — Kroi i Evrenes beut

2.2 — Kroi i Saraçhanes

2.3 — Krojet e Suzi Çelebisë

04 — Disa nga krojet e njohura nga ana e qytetarëve

4.1 — Kroi "Kuri Çeshme"

4.2 — Pasha Çeshmja

05 — Huluntimet e realizuara me ekspertë të trashëgimisë dhe qytetarë të Prizrenit

5.1 — Përmbledhja e intervistave me ekspertët e trashëgimisë kulturore.

5.2 — Huluntimi me qytetarët e Prizrenit

5.2.1 — Përfundimet e nxjerra nga pyetësi me qytetarë

06 — Historia e krojeve të Prizrenit

— Përfundime dhe rekomandime

— Fotografi të krojeve ndër vite

— Referencat

Lista e figurave

- Fig. 1 Kroi i Shatërvanit.
- Fig. 2 Kroi i Sinan Pashës.
- Fig. 3 Kroi i Esmâ Hanëmit.
- Fig. 4 Kroji i Qorr Agës.
- Fig. 5 Kroi i Binbashit.
- Fig. 6 Kroi i Destan Kabashit.
- Fig. 7 Kroi i Perollëve.
- Fig. 8 Kroi Topokli (6 krojet).
- Fig. 9 Kroi i Beledijes.
- Fig. 10 Kroi në teqën Halveti.
- Fig. 11 Krojet në Xhaminë e Mehmet Pashës.
- Fig. 12 Lavamani i kroit të Haxhi Fahrisë.
- Fig. 13 Lavamani i kroit të Abdullah Pomakut-Caka.
- Fig. 14 Kroi në shtëpinë e Sinjave.
- Fig. 15 Kroi në shtëpinë e Haxhi Rrustem Shportës.
- Fig. 16 Kroi Kuri Çeshme.
- Fig. 17 Kompleksi i Mahallës së Marashit dhe kroi Topokli.
- Fig. 18 Kroi i Beledijes në sheshin e Lidhjes.
- Fig. 19 Kroi te shtëpia e Shuaip Spahiut.
- Fig. 20 Kroi Binbashit.
- Fig. 21 Kroi afër katedralës "Zoja Ndihmëtare".
- Fig. 22 Kroi në oborin e hamamit të "Gazi Mehmed Pashës".
- Fig. 23 Kroi te shtëpia e "Shuaip Spahiut".
- Fig. 24 Tubimi afër kroit të Beledijes.
- Fig. 25 Kroi në lagjen Pantelia.
- Fig. 26 Kroi i Beledijes.

HYRJE

Çezmat publike luajnë një rol të rëndësishëm në krijimin e komuniteteve të shëndetshme, të lumtura dhe të qëndrueshme. Për këtë arsye, hapësirat publike në komunitet duhet të përfshijnë shumë vende të qasshme me ujë të pijshëm të freskët dhe të pastër për qytetarët.

Çezmat publike, të njohura edhe si kroje apo shatërvanë, zakonisht ndodhen në një vend qendror, në një park ose hapësirë publike që lidh njerëzit me vendin. Disa shatërvane në kohët e vjetra për shkak të dizajnit të tyre arkitekturor konsiderohen me shumë vlerë për trashëgiminë kulturore dhe historinë e atij populli.

Çezmat dhe burimet e ujit, janë akoma pjesë përbërëse e zhvillimit dhe inovacionit urban. Ato mund të transformojnë tërësisht pamjen dhe atmosferën e një hapësire, për të pasuruar ambientin e ndërtuar për një eksperiencë shumë më të këndshme.

Në të njëjtën kohë të pasurit e një apo më shumë çezmave/shatërvaneve mund të ndihmojnë në krijimin e një atmosfere natyrore në parqe dhe kopshte publike. Kjo vjen nga tingulli dhe estetika vizuale e përdorimit të një prej burimeve më të çmuara të natyrës siç është uji.

Po ashtu, burimet e ujit mund të luajnë një rol të rëndësishëm në reduktimin e efektit të ishujve të nxehtësisë urbane. Kjo për shkak se uji ul temperaturën lokale përmes procesit të avullimit, i cili transporton nxehtësinë jashtë qytetit. Çezmat/shatërvanet janë të vlefshme për komunitetin në tërësi dhe në këtë kuptim është e rëndësishme që ato të jenë të qasshme për të gjithë qytetarët.

EC Ma Ndryshe me anë të këtij hulumtimi ka për qëllim që të promovojë rëndësinë dhe vlerën e këtyre çezmave për historinë dhe trashëgiminë kulturore të Prizrenit. Ky hulumtim është realizuar në tre pjesë. Në pjesën e parë është hulumtuar në arkiva, libra dhe dokumente të ndryshme mbi çezmat që kanë ekzistuar dhe akoma ekzistojnë në Prizren, pastaj janë realizuar edhe intervista me ekspertë nga fusha e historisë dhe trashëgimisë kulturore dhe në fund është realizuar edhe një pyetësor me qytetarët e Prizrenit. Të gjitha këto përpjekje synojnë sigurimin e një pasqyreje të qartë mbi gjendjen e çezmave publike si dhe rëndësinë e tyre për qytetin e Prizrenit.

1. KROJET NËN MBROJTJE INSTITUCIONALE

1.1. Kroi i Shatërvanit

Në Qendrën Historike të Prizrenit, në afërsi të Xhamisë së Sinan Pashës, gjendet kroi i “Shatërvanit”. Supozohet se është ndërtuar në shek. XVII (pas ndërtimit të xhamisë së Sinan Pashës). Baza e kroit është në formë katrore me gur të latuar nga mermeri me ngjyrë të përhimtë, pjesa e sipërme ka formën e tetëkëndëshit. Pipëzat e ujit gjenden në katër anët e kroit në lartësi prej 1 m. Pjesa e sipërme formë të tetëkëndëshit, e zbukuruar me ornamente gjeometrike. Guacat për përcjelljen e ujit janë prej betoni në formë harkore të rrethuar me gurë të latuar. Uji prej guacave rrjedh në kanale. Kroi i Shatërvanit ndodhet në mes të Sheshit Shatërvan, i cili me pozitën e tij karakteristike, formën dhe dekorimet paraqet njërin prej simboleve të qytetit dhe njëherësh edhe Kroin më karakteristik të ruajtur deri më tani.



Fig. 1 Kroi i Shatërvanit

EMËRTIMET DHE REFERIMET

| | |
|----------------|--------------------|
| Numri Unik | 000428 |
| Emri: | Kroi i Shatërvanit |
| Klasa: | Monument |
| Institucioni: | QRTK – Prizren |
| Shteti: | Kosovë |
| Komuna: | Prizren |
| Emri i rrugës: | Sheshi Shatërvanit |
| Lloji(Tipi): | Arkitektuale |
| Periudha: | Osmane |
| Shekulli: | XVII |

1.2. Kroi i Xhamisë së Sinan Pashës

Kroi i Sinan Pashës i njohur edhe si Kroi i Xhamisë së Sinan Pashës është një monument i trashëgimisë kulturore që ndodhet në qytetin e Prizrenit. Kroi i Sinan Pashës është pjesë e Xhamisë së Sinan Pashës, gjendet në hyrje të xhamisë dhe është ndërtuar në kohën kur është ndërtuar edhe xhamia në fjalë.



Fig. 2 Kroi i Sinan Pashës

EMËRTIMET DHE REFERIMET

| | |
|----------------|---------------------------------------|
| Numri Unik | 000337 |
| Emri: | Xhamia e Sinan Pashës dhe kroji i tij |
| Klasa: | Monument |
| Institucioni: | QRTK – Prizren |
| Shteti: | Kosovë |
| Komuna: | Prizren |
| Emri i rrugës: | Sheshi Shatërvanit |
| Lloji(Tipi): | Arkitektuale |
| Periudha: | Osmane |
| Shekulli: | XVII |

1.3. Kroj i Esma Hanëmit

Kroj i gurit gjendet në oborrin e Muzeut Arkeologjik të Prizrenit. Vendndodhja e tanishme e tij nuk është ajo e kohës së ndërtimit. Në vitin 1975 kroj është zhvendosur nga rruga “Fehmi Lladrovci” (ish “Çlirimi i Popullit”) për shkak të punimeve infrastrukturore. Duke u bazuar në të dhënat gojore të trashëguara brez pas brezi ky kroat njihej si Kroj i Esma Hanëmit, e cila ishte donatore e ndërtimit të kroit. Bazuar në analogjinë me krojet e tjera publike të ndërtuara në Prizren, supozohet se ky kroat i takon pjesës së dytë të shek. XIX. Kroj gjatë kohës sa ka qenë i vendosur në rrugë ka shërbyer si kroat publik i lagjes. Kurse tani shërben si eksponat dhe kroat njëkohësisht. Kroj është punuar me gurë gëlqerorë të gdhendur me madhësi të ndryshme. Planimetria e tij është katrore që përfundon me një kurorë të profiluar thjeshtë, mbi të cilin është mbulesa (turbani) e punuar prej dy pjesëve në formë piramidale të punuar me gurë të gdhendur të profiluar. Në maje të kulmit është vendosur një gjyle metalike. Pjesa e ballores është gdhendur në formë të një kornize të profiluar brenda së cilës gjendet nisha, ku duhet të kishte qenë e vendosur pllaka e mbishkrimit. Vaska është njëpjesëshe e punuar po ashtu prej guri gëlqeror. Gjatë zhvendosjes së kroit në vendin aktual është ndryshuar lartësia e saj origjinale dhe në vend të tri hapjeve për depërtim të ujit është bërë vetëm një.



Fig. 3 Kroj i Esma Hanëmit

EMËRTIMET DHE REFERIMET

| | |
|----------------|---------------------------|
| Numri Unik | 002922 |
| Emri: | Kroj i Esma Hanëmit |
| Klasa: | Monument |
| Institucioni: | QRTK – Prizren |
| Shteti: | Kosovë |
| Lokaliteti: | Në oborrin e Sahat Kullës |
| Komuna: | Prizren |
| Emri i rrugës: | Sahat Kulla |
| Lloji(Tipi): | Arkitektuale |
| Periudha: | Osmane |
| Shekulli: | XIX |

1.4. Kroi i Qorr agës “Haxhi Ramadanit”

Kroi i Haxhi Ramadanit (Qorr Agës) gjendet në kuadër të xhamisë së Haxhi Ramadanit në lagjen e re. Kroi është ndërtuar afër xhamisë dhe me një mur rrethues të xhamisë, në popull njihet si Kroi i Qorr Agës. Bazuar në analogjinë e krojeve publike në Prizren, forma, materiali dhe teknikat e ndërtimit na tregojnë se ky kroi u ndërtua në fund të shekullit të XIX. Nga koha e ndërtimit, e deri në ditët e sotme, Kroi i Qorr Agës, shërben si kroi i lagjes për furnizimin me ujë të banorëve të kësaj lagje, dhe për nevojat e mirëmbajtjes së higjienës për besimtarët që shfrytëzojnë xhaminë. Planimetria e Kroit është drejtkëndëshe që përfundon me një kurorë të profiluar thjeshtë, në formë piramidale dhe të punuar me gurë të gdhendur dhe me gurë gëlqerorë. Në pjesën ballore ka një përpunim-gdhendje të cektë në formë kornize me harqe të shkallëzuara, të profilizuara, me gjerësi rreth 7.5 cm.

Që nga fillimi i ndërtimit, Kroi i Qorr Agës është aty, d.m.th nuk i'u është lëvizur vendi asnjëherë. Po ashtu, kroi ka përfunduar me një kurorë të punuar me katër rende tullash prej argjilës së pjekur dhe me një rend gurësh shpuzë, dhe në fund është vendosur një rend tjegulla të larguara. Gjatë një studimi që është bërë para disa viteve, është vërtetuar se kurora që ka tani kroi, nuk është origjinale. Në restaurimet e bëra në vitin 2014, është vërtetuar që kurora origjinale është ndërtuar në shekullin e XIX. Kjo kurorë përbëhet prej 3 pjesëve, pa ndonjë trajtim dekorativ. Por me kalimin e kohës, kurora është tjetërsuar. Vitet e fundit janë rindërtuar pjesët e dëmtuara të këtij kroi.



Fig. 4 Kroji i Qorr Agës

EMËRTIMET DHE REFERIMET

| | |
|----------------|-----------------------------|
| Numri Unik | 003631 |
| Emri: | Kroi i Qorr Agës |
| Klasa: | Monument |
| Institucioni: | QRTK - Prizren |
| Shteti: | Kosovë |
| Lokaliteti: | Te Xhamia e Haxhi Ramadanit |
| Komuna: | Prizren |
| Emri i rrugës: | Saraçët |
| Lloji(Tipi): | Arkitektuale |
| Periudha: | Osmane |
| Shekulli: | XIX |

1.5. Kroi i Binbashit

Kroi Binbashi gjendet në perëndim të qendrës historike të Prizrenit, pranë Xhamisë “Iljaz Kuka” dhe ndërtesës së Beledijes. Për kohën e ndërtimit dhe ndërtuesin e tij nuk posedojmë informata të sakta. Informatat që paraqiten në mbishkrimin e shkruar në gjuhën e vjetër osmane tregojnë për donacionin e bërë nga një person ushtarak (Binbashi) në vitin 1902 për restaurimin e kroit. Në bazë të kësaj informate edhe kroi njihet si Kroi Binbashi. Kroi prej kohës kur është ndërtuar e deri më sot shërben si krua publik. Planimetria e tij është katrore që përfundon me një kurorë të profiluar thjeshtë, mbi të cilin është mbulesa (turbani) e përbërë prej tri pjesëve në formë piramidale, të punuar me gurë të gdhendur të profiluar. Pjesa e ballores është gdhendur në formë të një kornize të profiluar brenda të cilit gjenden dy nisha. E para ka formë të hapjes me hark të thepisur dhe shërben për vendosjen e sapunit, kurse e dyta ka formë drejtkëndëshe ku ka qenë i vendosur mbishkrimi. Mbishkrimi është larguar nga kroi gjatë viteve '70 dhe tani gjendet në Muzeun Arkeologjik të Prizrenit. Prej kohës kur është ndërtuar e deri më tani, kroi ka mbetur në vendin fillestar me disa adaptime të ambientit përreth. Gjatë restaurimit të kroit në vitin 2014 janë gjetur gypat prej qeramike origjinale prej nga ka rrjedhë uji nga përrrenjtë që degëzoheshin nga lumi Lumbardhi. Kroi është i vendosur në veri të Xhamisë “Iljaz Kuka”, në trotuar, ku bëhet kryqëzimi i dy rrugëve, rruga: “Shuaip Spahiu” dhe rruga “Iljaz Kuka”. Kroi i takon tipit të krojeve të mbështetura të cilat janë ndërtuar pranë ndërtesave të vendosura në kënd të rrugëve. Ka planimetri pothuajse katrore me dimensione 98 x 90 cm.



Fig. 5 Kroi i Binbashit

EMËRTIMET DHE REFERIMET

| | |
|----------------|-----------------------------------|
| Numri Unik | 000427 |
| Emri: | Kroi i Binbashit |
| Klasa: | Monument |
| Institucioni: | QRTK – Prizren |
| Shteti: | Kosovë |
| Lokaliteti: | Në afërsi të Xhamisë “Iljaz Kuka” |
| Komuna: | Prizren |
| Emri i rrugës: | Shuaip Spahiu |
| Lloji(Tipi): | Arkitektuale |
| Periudha: | Osmane |
| Shekulli: | XIX |

1.6. Kroi i Destan Kabashit

Kroi i Destan Kabashit gjendet në oborrin e shtëpisë së tij, në veri të Qendrës historike të Prizrenit. Në bazë të fletës poseduese origjinale, kroi është ndërtuar në vitin 1898, në të njëjtin vit kur është ndërtuar edhe shtëpia. Gjatë kohës kur është ndërtuar kroi ka shërbyer për nevojat e pronarëve të shtëpisë dhe gjatë ditës edhe për nevojat e banorëve të lagjes. Sot shfrytëzohet vetëm nga pronarët e shtëpisë. Ka një trajtim të veçantë në aspektin e formës, dimensioneve, teknikës së ndërtimit dhe trajtimit artistik. Kroi përbëhet nga dy pjesë kryesore: vaska e punuar nga guri gëlqeror monolit, me trajtë ovale, e cila karakterizohet për linjat harkore të gdhendura me mjeshtëri dhe hapësirat për rrjedhje të ujit. Pjesa ballore është e punuar gjithashtu nga guri gëlqeror monolit me bazë drejtkëndëshe dhe maje harkore. Guri ballor dallohet me trajtimin e lartë artistik, ku vlen të theksohet dekorimi me motive florale, i punuar me teknikë tradicionale të gurgdhendjes. Prej kohës kur është ndërtuar e deri më tani, kroi ka mbetur në vendin fillestar me disa adaptime të vogla. Ky kroi me formën, përmasat, teknikën e ndërtimit dhe trajtimin e lartë artistik paraqet një shembull të veçantë të krojeve familjare të ndërtuara në fillim të shek. XX në Prizren.



Fig. 6 Kroi i Destan Kabashit

EMËRTIMET DHE REFERIMET

| | |
|----------------|---|
| Numri Unik | 002923 |
| Emri: | Kroi i Destan Kabashit |
| Klasa: | Monument |
| Institucioni: | QRTK – Prizren |
| Shteti: | Kosovë |
| Lokaliteti: | Në oborrin e shtëpisë së Vahid Kabashit |
| Komuna: | Prizren |
| Emri i rrugës: | Selajdin Braha |
| Lloji(Tipi): | Arkitektuale |
| Periudha: | Osmane |
| Shekulli: | XIX |

1.7. Kroi i Familjes Perolli

Kroi i familjes Perolli gjendet në oborr të shtëpisë, në veri të Qendrës historike të Prizrenit. Në bazë të mbishkrimit të gdhendur në gurin ballor është ndërtuar në vitin 1846, nga Fejzullah Spahiu, i biri i Shuaip Pashë Spahiut, udhëheqës i Degës së Prizrenit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Prej kohës kur është ndërtuar e deri më sot ka shërbyer si krua familjar. Kroi përbëhet nga dy pjesë kryesore: vaska e punuar nga guri mermer i bardhë, në formë ovale, e cila karakterizohet për linjat harkore të gdhendura me mjeshtëri dhe hapësirat për rrjedhje të ujit, dhe pjesa ballore, e punuar gjithashtu nga guri mermer i bardhë me bazë drejtkëndëshe dhe majë në formë të valëzuar harkore. Guri ballor dallohet me trajtimin e lartë artistik, ku vlen të theksohet dekorimi floral dhe gjeometrik që përfundon me një tufë gjethesh të stilizuara, të punuara në relief. Krahas dekorimeve në gurin ballor është i gdhendur mbishkrimi kaligrafik në gjuhën osmane, ku janë shënuar të dhënat për donatorin dhe vitin e ndërtimit. Ky krua me formën, përmasat, teknikën e ndërtimit dhe trajtimin e lartë artistik paraqet një shembull të veçantë të krojeve familjare të ndërtuara gjatë shek. XIX në Prizren.



Fig. 7 Kroi i Perollëve

EMËRTIMET DHE REFERIMET

| | |
|----------------|-----------------------------------|
| Numri Unik | 004136 |
| Emri: | Kroi i Perollëve |
| Klasa: | Monument |
| Institucioni: | QRTK - Prizren |
| Shteti: | Kosove |
| Lokaliteti: | Në oborrin e shtëpisë së Perollve |
| Komuna: | Prizren |
| Emri i rrugës: | Sahat Kulla |
| Lloji(Tipi): | Arkitektuale |
| Periudha: | Osmane |
| Shekulli: | XIX |

1.8. Kroj Topokli (6 Krojet)

Topoklia apo 6 Krojet janë ndër objektet kulturore më me rëndësi në Prizren. Këto kroje gjinden në hyrje të lagjes së Marashit, përballë shtëpisë së Ymer Qysesë. Gjithsejtë ka gjashtë cepa të punuar në bronz, dhe një vaskë prej guri. Nuk dihet saktësisht, se kur është ndërtuar, por mendohet që ekziston para ardhjes së Perandorisë Osmane në trojet tona. Specifikë e gjashtë krojeve ishte se nuk janë tharë asnjëherë, edhe gjatë thatësirave më të mëdha, e nuk janë ndotur as gjatë vërshimeve më të mëdha. Në vitin 1995 është bërë rivitalizimi i tyre, por në një formë jo origjinale, duke futur elemente të huaja në ndërtimin e tyre.



Fig. 8 Kroj Topokli (6 krojet)

EMËRTIMET DHE REFERIMET

| | |
|----------------|------------------------|
| Emri: | Kroj Topokli (6krojet) |
| Klasa: | Monument |
| Institucioni: | QRTK – Prizren |
| Shteti: | Kosovë |
| Lokaliteti: | Në lagjen Marash |
| Komuna: | Prizren |
| Emri i rrugës: | Vatra Shqiptare |
| Lloji(Tipi): | Arkitektuale |
| Periudha: | /// |
| Shekulli: | /// |

1.9. Kroi i Beledijes

Emrin e ka marr nga vetë objekti i Kuvendit Komunal të Prizrenit, që u ndërtua gjatë periudhës osmane, në shekullin XIX. Kroi është ndërtuar në oborrin e Beledijes, siç quhet në gjuhën turke Kuvendi, gjatë shek. XIX. Kroi gjendej ndërmjet objektit të “Beledijes” dhe Xhamisë së Mustafë Pashës. Në këtë vend kroi e kreu funksionin e vet primar nga koha e ndërtimit e deri në vitet 1960. Asokohe lagjja pësoi ndryshime të paparapara. Xhamia e Mustafa Pashës u rrënuar më 1952. Në anën e djathtë të lumit u ndërtua dhe asfaltua aksi rrugor nga “Tabakhana” e deri në “Marash”. Kroi ndodhej në aks të rrugës. Si rrjedhojë e ndërtimit të aksit rrugor, kroi më 1963 u dislokua në “Sheshin e Dëshmorëve”, i cili gjendet në pjesën qendrore të qytetit, ndërmjet urës e Xhamisë së Arastës dhe Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Kroi është i ndërtuar nga gurët gëlqeror të latuar. Gjatë përpunimit, blloqeve të gurëve u është dhënë forma e katrorëve, me madhësi të ndryshme.

Në pjesën e sipërme, në të katër anët e tij, ngrihen harqe, e mbi to është vendosur një gur gjysmë sferik. Në pjesën ballore të kroit është një profil i cekët, në formë kornize, ku brenda saj duhej të ishte mbishkrimi me të dhëna elementare për të, por kjo mungon. Kroi është me një sylinjare. Ujin e merrte nga ujësjellësi i qytetit. Vaska e tij është nga betoni dhe gurët janë katrorë .



Fig. 9 Kroi i Beledijes

EMËRTIMET DHE REFERIMET

| | |
|----------------|---------------------------------------|
| Numri Unik | 000426 |
| Emri: | Kroi i Beledijes në Sheshin e Lidhjes |
| Klasa: | Monument |
| Institucioni: | QRTK - Prizren |
| Shteti: | Kosovë |
| Lokaliteti: | Arasta - Sheshi i dëshmorëve |
| Komuna: | Prizren |
| Emri i rrugës: | Sheshi i Lidhjes |
| Lloji(Tipi): | Arkitektuale |
| Periudha: | Osmane |
| Shekulli: | XIX |

1.10. Krojet e Teqesë së Tarikatit Halveti

Gjenden në kuadër të teqesë dhe janë të njëkohshme me ndërtimin e teqesë, shekulli XVI-XVII. Krojet kanë katër pipa bronzi. Ato rrethohen me një kalldrëm gurësh të bardhë të oborrit të teqesë dhe përbëjnë një pamje shumë të bukur.

Krojet kanë ruajtur origjinalitetin deri në ditët e sotme dhe përbëjnë një pjesë shumë të rëndësishme të kompozicionit arkitekturor të teqesë.



Fig. 10 Kroi në teqën Halveti

EMËRTIMET DHE REFERIMET

| | |
|----------------|----------------------------|
| Numri Unik | 000404 |
| Emri: | Teqja Halveti dhe kroji |
| Klasa: | Monument |
| Institucioni: | QRTK – Prizren |
| Shteti: | Kosovë |
| Lokaliteti: | Teqeja e Tarikatit Halveti |
| Komuna: | Prizren |
| Emri i rrugës: | Teqeja Halveti |
| Lloji(Tipi): | Arkitektuale |
| Periudha: | Osmane |
| Shekulli: | XVII |

1.11. Krojet e Xhamisë së Gazi Mehmet Pashës

Gjenden në oborrin e Xhamisë së Bajraklisë. Përbëhen nga tetë kroje, të ndërtuara në vitin 1573-1574 në kohën kur u ndërtua edhe xhamia. Krojeve i humbi origjinaliteti në vitin 1992, kur u bë një intervenim gjatë restaurimit të xhamisë. Kishin shërbyer dhe vazhdojnë të shërbejnë për pastrim të predikuesve para lutjeve në Xhami, por edhe për freskim dhe pirje.



Fig. 11 Krojet në Xhaminë e Mehmet Pashës

EMËRTIMET DHE REFERIMET

| | |
|----------------|--|
| Numri Unik | 000351 |
| Emri: | Xhamia e Mehmed Pashës dhe tetë krojet |
| Klasa: | Monument |
| Institucioni: | QRTK - Prizren |
| Shteti: | Kosovë |
| Lokaliteti: | Xhamia e Mehmed Pashës |
| Komuna: | Prizren |
| Emri i rrugës: | Bajrakli |
| Lloji(Tipi): | Arkitektuale |
| Periudha: | Osmane |
| Shekulli: | XVII |

2. KROJET FAMILJARE

Krojet familjare janë krojet që janë ngritur në oborre të gjera dhe me përplot gjelbërim të shtëpive të Prizrenit dhe ato simbolizojnë pozitën dhe standardin e lartë të familjeve që u përkisnin.

Sipas kërkimeve të vitit 1972, të plotësuara në vitin 1995, në hapësirën urbane të Prizrenit ekzistojnë krojet vijuese familjare:

2.1. Kroi në shtëpinë e Abdyl Perollit

Është kroi me reprezentativ i Prizrenit si për trajtën e tij skulpturale ashtu dhe për shkak të mbishkrimit në të. Është punuar me një mjeshtëri të rrallë në mermer të bardhë dhe në të dominon ornamenta floral që përfundon me një tufë prej fletësh të stilizuara, të punuara në relief. Uji rridhte nga dy pipa të metaltë. Veçori e kroit është mbishkrimi kaligrafik (10x54cm), nga i cili kuptohet se kroine ndërtoi kryefamiljari Fejzullah Spahiu, i biri i Shuaip Spahiut, lider dhe kryetar i degës së Prizrenit të LSHP. Për kroit u kujdes trashëgimtari Aziz Perolli (1926) por, kroi nuk është cilësuar monument kulturor.

2.2. Kroi në shtëpinë e Haxhi Fahrisë

U ndërtua në shek XVII, së bashku me shtëpinë folklorike të prindërve të gruas së tij Ferdanes, që gjendej te “Arasta Çarshia”. Shtëpia u rrënua në vitin 1933 dhe u ngrit shtëpia e tanishme, e cila u konfiskua më 1948.

Kroi është punuar nga mermeri i bardhë, në stil baroku. Falë vlerave skulpturale të tij kaloi në pronësi të Hamdi Bajmakut, ndërsa pjesa tjetër ngeli në oborrin e ish-shtëpisë së Haxhi Fahrisë i cili u shndërrua në objekt të Komitetit Komunal të LK të Prizrenit.



Fig. 12 Lavamani i kroit të Haxhi Fahrisë

2.3 Kroi në shtëpinë e Abdullah Pomakut – Caka

Supozohet të jetë ndërtuar në shekullin XVII, duke pasur parasysh edhe faktin se ky furnizohet me ujë nga rrjeti i krojeve në Teqenë e Tarikatit Helveti, si dhe ai në shtëpinë e Haxhi Fahrisë, andaj supozohet se edhe ky ishte o punuar nga mermeri i bardhë në stil baroku. Sipas një supozimi këtë e punuan mjeshtrit goge, të sjellë në qytet nga familja sundimtare lumjane e Rrotullëve, ndërsa sipas tjetrit, kroi është importuar nga Shkupi.



Fig. 13 Lavamani i kroit të Abdullah Pomakut-Caka

Abdullah Pomaku – Caka ishte adhurues i gurgdhendjes dhe nga koha e tij janë trashëguar punime të tjera, siç janë shkallaret, fondametet e shtyllave të hardhisë, gurët rreth përroit, etj. Këto që u thanë dhe fakti se mermeri i bardhë nuk gjendet në afërsi, imponojnë pyetjen se mos gurgdhendjet u importuan apo u skalitën në vend me mermerin e sjellë.

2.4 Kroi në shtëpinë e Sinjave

Gjendet në mahallën e “Iliaz Kukës”. Është gdhendur në gurë në trajtën e katërkëndëshit dhe, pas ndryshimeve gjatë adaptimeve, nuk posedon më vlera skulpturale.



Fig. 14 Kroi në shtëpinë e Sinjave

2.5 Kroi në shtëpinë e Haxhi Rustem Shportës

Është një kroi që e ruajti trajtën origjinale. Shtëpia ku gjendej, përplot elemente folklorike, pësoi ndryshime në vitin 1965 dhe ngeli vetëm mozaiku i vlefshëm i dyshemesë në hajat, me vlera të kulturës materiale. Kroi me koritën janë punuar në gurgdhendje, nga krijues të panjohur. Sipas materialit të përpunuar mund të konkludohet se krijuesit ishin vendas, që punuan me një stil original, sipas trajtave të krojeve publike të qytetit të lashtë. Në pjesën veriore të oborrit ekzistonte dhe ashtuquajtura “terazia e krojeve”, e punuar në gurgdhendje. Në këtë pikë nivelizohej dhe ndahej uji për tri kroje për kroit e shtëpisë, atë të Beut dhe për kroit e mahallës, prej nga vazhdonte në kroit e shtëpisë së Haxhi Destanit. Deri në këtë pikë të ndarjes uji vinte përmes rretit të ujësjellësit nga kroi publik i “Tash Çeshmes”. Më vonë, kjo pikë e ndarjes u punua nga betoni dhe kishte një kapak hekuri, që mbyllej me dry, ndërsa çelësin e mbanin çezmaxhinjtë e Beledijes. Këta, kohë pas kohe, derdhnin bujashka në gypat e ujësjellësit për t’i pastruar. Haxhi Rustem Shporta, që i takonte plejadës së intelektualëve të qytetit të lashtë, ishte njeri me kulturë të gjerë që kishte një bibliotekë personale me shumë vepra, pos tjerash edhe 18 vepra në dorëshkrim, me një vlerë të veçantë shoqërore.



Fig. 15 Kroi në shtëpinë e Haxhi Rustem Shportës

3. KROJET E HUMBURA

Në mesin e krojeve të zhdukura që kishin vetëm vlera praktike janë:

3.1. Kroji i Evrenes beut

Gjendej në hapësirën midis Hamamit të Gazi Mehmed Pashës dhe Xhamisë së Arastës. Këto u ndërtuan në vitin 1584, hamami gjerë në vitin 1964. Krojet kishin katër pipa të thjeshtë prej hekuri, kishin një hapësirë katërkëndëshe përreth dhe pjesa veriore e lindore kishin dy shkallë. Krojet u shërbenin shfrytëzuesve të Çarshisë së drithërave, asaj të terzinjve dhe të hamamit.

Ndonëse këto kroje nuk kishin ndonjë vlerë të madhe artistike, vlera e tyre qëndronte në autoritetin e ndërtuesit dhe të mbishkrimit të gdhendur në të në gjuhën e vjetër turke. Mbishkrimi nuk është ruajtur por teksti i tij gjendet në veprën e J. Jastrehov dhe ai është si vijon: “Shkëlqesia dhe ngadhënjyesi Evrenos beg i biri i Ahmet beut, pasi që vendosi që ta ndërtoj kroin, i porositi mjeshtrit dhe mbikëqyrjen e përfundoi me 993 me ndihmën e Zotit, i cili simbolizon burimin e jetës”. Krojet u rrënuan më 1964 me rastin e rregullimit të hapësirës së Hamamit të Gazi Mehmed Pashës.

3.2. Kroji i Saraçhanes

Gjendej në trekëndëshin që përbënte Saraçhanja, hapësira e farkëtarëve dhe e pazarit të drithrit. Kroji kishte katër pipa të thjeshtë prej hekuri dhe shatërvanin e rrumbullakët të vendosur në nivelin e kalldrëmit të rrugës. Objekti nuk kishte ndonjë vlerë të posaçme andaj u rrënuar me rastin e rregullimit të hapësirës së hamamit dhe gjatë ndërtimit të rrugës së asfaltuar më 1964.

3.3. Krojet e Suzi Çelebisë

Në mesin e krojeve publike, që nuk ekzistojnë më vend të veçantë kishin krojet e Suzi Çelebisë, në afërsi të xhamisë së tij. Ato u punuan nga mermeri i bardhë, i sjellë nga Shkupi, ndërsa tre pipat ishin të punuara në bronz. Të gjitha këto kroje funksionin deri në vitin 1958, kur filloi rindërtimi i rrjetit të ujësjellësit të qytetit.

4. DISA NGA KROJET E NJOHURA NGA ANA E QYTETARËVE

4.1. Kroi "Kuri Çeshme"

Kroi "Kuri Çeshme" gjendet nën varrezat myslimane, në rrugën Prizren – Hoça e Qytetit. U ndërtua në vitin 1912, sipas projektit të Momir Korunovic, toger i ushtrisë serbe, e cila atë vit gjendej në pozicionet e pushtuara në afërsi të Kukësit, tani është rrënuar me eksploziv (XI. 1999).



Fig. 16 Kroi Kuri Çeshme

4.2. Pasha Çeshmja

Pasha Çeshmja është një krua që gjendet në një kodër afër Kalasë së Prizrenit. Ky krua ka qenë pjesë e burgut në periudhën e Perandorisë Osmane. Poashtu, mendohet se kroi në fjalë ishte burgu për eprorë dhe jeniçerë, që dënoheshin me ferman nga Perandoria Otomane. Në vendin tonë kjo njihet edhe si Çezma e Pashës. Për këtë çezme ka gojëdhënatë ndryshme si: Ndiemon në zgjidhjen e halleve dhe problemeve të ndryshme, mendime të ndryshme! Në atë kohë, mendohet se Uji Pasha Çeshmes, ishte nxitës për dashuri, dhe shumë nga të burgosurit e pinin atë, dhe binin në dashuri. Një gojëdhënë tjetër shpjegon se uji i këtij kroi lidhej ngushtë edhe me kultin e zjarrit e kjo kishte të bënte me ripërtëritjen e natyrës dhe bimësisë. Vlen të përmendet se Pasha Çeshme ka luajtur rol të rëndësishëm edhe në kohën kur është ndërtuar Kalaja e Prizrenit dhe Kalaja e Cucave.

Pas përfundimit të Luftës së Dytë botërore, në Pasha Çezmë ka patur një vendbanim. Kryesisht banorët ishin nga Luma e Shqipërisë, për shkak të kulltoavë dhe uji i shëndetshëm që ishte.

Table 2 Lista e krojeve ekzistuese dhe krojeve joekzistuese.

| KROJET E HUMBURA | KROJET EKZISTUESE |
|--|---|
| Dy krojet e sarajit | Kroi i Shadërvanit |
| Krojet e Nënkalasë | Kroi i Sinan Pashës |
| Kroi Iljaz Kuka | Kroi i Beledijes |
| Kroi i Terzimahallës (te Xhamia) | Kroi i Binbashit |
| Krojet te Xhamia e “Suzi Çelebiut” | Kroi i Esmë Hanëmit (Gurit) |
| Kroi te shtëpia e Shuaip Spahijut | Kroi i Qorr Agës |
| Kroi te Qafa Kishës | Kroi Topokli (6 Çeshmet) |
| Kroi në oborrin e Hamamit Gazi Mehmet Pashës | Kroi i Destan Kabashit |
| Kroi te shtëpia e Ardian Zurnaxhiut | Kroi i Familjes Perolli |
| Krojet e Evrenes beut | Krojet e Xhamisë së Bajraklisë |
| Kroi në shtëpinë e Sheh Zades | Krojet e Teqes Halveti |
| Kroi në shtëpinë e Jashar Matushës | Kroi i Pantelisë |
| Kroi afër Kishës së Shën Premtës | Kroi i Gani Telallit |
| Kroi përpara komunës (ish tregu) | Kroi Gani Çavdërbasha |
| Kroi kuri çeshme (te varrezat) | Kroi Adem Jashari 1 |
| | Kroi Adem Jashari 2 |
| | Kroi në Jeni Mahallë |
| | Kroi te Xhamia e Jeni Mahallës |
| | Krojet në Namazgjah |
| | Krojet në Dragoman |
| | Kroi te Beteja e Llapushnikut |
| | Kroi te Xhamia e Kurillës |
| | Krojet te Varrezat |
| | Kroi Selajdin Berisha |
| | Kroi Selajdin Braha |
| | Kroi në Ortakoll (Xhamia Antalja) |
| | Kroi te Xhamia e Hoqamahallës |
| | Kroi në rrugën “Remzi Ademaj” |
| | Krojet në oborrin e Xhamisë së Sinan Pashës |

LOKACIONET E KROJEVE TË PRIZRENIT



1. Kroi i Shatërvanit

2. Kroi i Sinan Pashës

3. Kroi Topokli

4. Kroi i Beledijes

5. Kroi i Binbashit

6. Kroi i Esma Hanemit

7. Kroi i Familjes Perolli

8. Kroi i Destan Kabashit

9. Kroi i Qorr Agës

10. Kroi i Teqes Halveti

11. Krojet e Xhamisë së
Gazi Mehmet Pashës

5. HULUMTIMET E REALIZUARA ME EKSPERTË TË TRASHËGIMISË DHE QYTETARË TË PRIZRENIT

Në këtë pjesë të hulumtimit do të gjeni të dhënat nga intervistat e realizuara me ekspertë të trashëgimisë kulturore dhe pyetësin e realizuar me qytetarët e Prizrenit.

5.1. Përmbledhja e intervistave me ekspertët e trashëgimisë kulturore

Deri në fillim të shek. XX çezmet (krojet) publike kanë qenë burim i vetëm (me disa përjashtime ku nëpër oborre ka pasur edhe puse - bunarë) i furnizimit të shtëpive me ujë për pije, gatim dhe pastrim. Tek pas Luftës së Dytë Botërore roli i krojeve (publike) fillon të bie pasi fillohet me furnizimin e shtëpive me ujë përmes sistemi të rrjetit të ujësjellësit dhe atë fillimisht vetëm nëpër qendrat urbane, derisa në ato rurale furnizimi ka qenë përmes puseve ose krojeve publike që nuk kanë qenë me numër të madh. Tani krojet publike kanë po ashtu rëndësi pasi ato i plotësojnë nevojat e kalimtarëve e veçanërisht të turistëve që frekuentojnë qytetin.

Përveç funksionit të tyre praktik, ato janë edhe një pjesë e trashëgimisë kulturore që tregon për një periudhë të caktuar kohore në historinë e qytetit. Forma e tyre unike dhe materialet e përdorura në ndërtim tregojnë për kreativitetin dhe aftësitë e ndërtimeve të lashta.

Vlerësohet të ketë pasur shumë më shumë kroje në të kaluarën sesa tani pasi rrethanat e kohës, krijonin varshmëri nga këto kroje publike ngase shumë rrallë kanë qenë raste ku shtëpitë kishin furnizim nga rrjeti i ujësjellësit. Sipas sallnames (raport vjetor) së Prizrenit të vitit 1874 (1291 hixhri) Prizreni ka pasur rreth 150 kroje, ndërsa pas 22 viteve me 1896 numri i tyre duket se fillon të bie gradualisht pasi janë evidentuar rreth 130 kroje, ku çdo lagje dhe mahallë ka pasur së paku një të tillë ku banorët e asaj lagje furnizoheshin nga to. Shkatërrimi i tyre masiv fillon me fillimin e urbanizimit të qytetit duke filluar nga viti 1924 dhe më vonë, me plane të reja urbanistike kur ndërtoheshin objekte të reja dhe rregulloheshin rrugët dhe shtrati i lumit.

Pra me zhvillimin e infrastrukturës së qytetit, funksioni i krojeve publike po ulej, por jo edhe rëndësia e tyre. Sipas tyre, krojet e Prizrenit ishin vendet ku qytetarët kishin krijuar shumë kujtime.

Krojet në të kaluarën janë ndërtuar nga pushteti i atëhershëm si domosdoshmëri dhe nevojë, por ka pasur shumë raste kur ato janë ndërtuar edhe nga individët e ndryshëm. Në pikat strategjike të lagjeve dhe shesheve krojet zakonisht janë ndërtuar nga pushteti si një obligim dhe përkujdesje ndaj popullatës, ndërsa kur ato janë ndërtuar nga individët ato kanë pasur për qëllim bamirësi, përkujtimi dhe më radhë për prestigj.

Krojet janë ndërtuar zakonisht nga 3 grupet e njerëzve: mirëbërësit, të pasurit dhe udhëheqësit institucional të qytetit.

Si pasojë e mangësive në infrastrukturën e qytetit, nuk ishte e mundur që të gjitha shtëpitë të kishin kroje në shtëpitë të tyre, por në çdo lagje, treg, dhe kryqëzim rrugësh kishin kroje të vendosura që shërbente banorëve të atyre zonave.

Disa kroje nuk janë në vendet e tyre të mëparshme, pasi janë zhvendosur për arsye të nevojës së zgjerimit të rrugëve për komunikacion, por disa edhe janë larguar tërësisht, si ajo para administratës komunale, ku më herët ishte si vend pazar.

E njëjta ka ndodhur edhe me kroit e Perollit ku trashëgimtari i kroit të babait të tij, tha se vendndodhja e tij është ndryshuar 3 herë për arsye të ndryshimit të oborrit, por u theksua se kjo procedurë kjo është realizuar me kujdes të shtuar.

Sipas tyre edhe në ditët e sotme vazhdon kjo praktikë, natyrisht me përmasa shumë më të vogla. Pushteti vazhdon ndërtimin e krojeve më tepër në kuadër të ndonjë projekti rregullues ose si element dekorativ që zakonisht shprehet në formë të shatërvaneve, fontanave ose pishinave gufuese si element freskues. Individët po ashtu vazhdojnë ndërtimin e krojeve në shumtën e rasteve si element përkujtues për ndonjë familjar të tyre por ka raste kur ato bëhen edhe për qëllime bamirësie.

Gjendja e krojeve nuk është për t'u lavdëruar. Ato sikurse çdo objekt tjetër duhet mirëmbajtur vazhdimisht dhe në mënyrë sistematike. Por në rastin e krojeve duket se përkujdesja dhe mirëmbajtja duhet të jetë më shpesh për shkak të dëmtimeve që shkaktohen nga persona të pandërgjegjshëm dhe vandal. Veç kësaj natyra e këtyre objekteve dhe kushtet klimatike (kontinentale) të vendit tonë ndikojnë negativisht në strukturën ndërtimore të tyre. Investimet nga institucionet kompetente në këto objekte natyrisht që nuk janë të mjaftueshme, kjo pasi nga ana e tyre nuk shihen si prioritet dhe nuk janë si raste emergjente përkundër objekteve tjera që janë para kolapsi.

Vendosja e info-tabelave ose mënyrat tjera informimi për kroje (jo vetëm) janë shumë me rëndësi sipas tyre, pasiçë ato shpesh herë janë pjesë e kronologjisë historike të lagjes, qytetit ose të shtetit.

Vlerësohet që ka interesim nga ana e institucioneve për krojet e Prizrenit, por jo në masë të kënaqshme. Në vitin 2017, Qendra Rajonale për Trashëgimisë Kulturore (QRTK) kishte bërë pastrimin dhe konservimin e 7 krojeve të cilat janë në listën e trashëgimisë nën mbrojtje nga ana e shtetit. Por nuk përmendet ndonjë aktivitet apo investim tjetër që ka shërbyer për ruajtjen dhe promovimin e këtyre krojeve nga ana e institucioneve.

5.2. Hulumtimi me qytetarët e Prizrenit


EEC Ma Ndryshe për ta plotësuar më shumë këtë hulumtim ka realizuar një pyetësor me qytetarët e Prizrenit në lidhje me krojet (çezmat) dhe historinë e tyre.

Qëllimi kryesor i kësaj pjese të hulumtimit të realizuar ka qenë që të merret një vlerësim direkt nga ana e qytetarëve mbi gjendjen ekzistuese të krojeve (çezmave), respektivisht sa janë ruajtur, sa janë funksionale, të qasshme dhe të shfrytëzueshme për të gjithë, dhe se a janë të mjaftueshme këto kroje për ta. Në këtë hulumtim janë anketuar gjithsejtë 120 qytetarë prej të cilëve 48 ishin gra dhe 72 ishin burra.


A ka çezmë/krua publike në lagjen ku ju banoni?



Nëse po, a keni informacion se sa e vjetër është çezma ekzistuese në lagjen tuaj?




A është funksionale?




Nëse jo, a mendoni se duhet të ketë çezme/krua në lagjen ku ju banoni?




Sa shpesh i përdorni çezmat/krojet publike?




A keni njohuri a kanë rrjedhje të ujit gjatë gjithë vitit?




A keni njohuri për çezmat/krojet që janë nën mbrojtje të shtetit?




Nëse po, ku jeni informuar për këto çezme/kroje?




Sipas mendimit tuaj, a është ruajtur gjendja fizike e çezmave/krojëve publike (identiteti, arkitektura)?



A duhet të shtohet kujdesi nga shteti për çezmat/krojet tradicionale të Prizrenit?




A duhet të shtohet kujdesi nga qytetarët për çezmat/krojet tradicionale të Prizrenit?



A mendoni se çezmat/krojet publike janë të qasshme për PAK (persona me aftësi të kufizuar)?



Cilat hapa mendoni se duhet të ndërmerren për përmirësimin e gjendjes së tyre? (mund të përzgjidhni më shumë se një opSION)



72.5% - Të funksionalizohen çezmat/krojet jo funksionale

77.5% - Të restaurohen çezmat/krojet jo funksionale dhe të dëmtuara duke ruajtur identitetin e tyre

56.7% - Të vendosen në listën e monumenteve të mbrojtura me ligj nga MKRS

69.3% - Të vendosen tabela informuese me fakte historike mbi çezmat/krojet publike

6% - Asnjë nga hapat e mësipërm, gjithçka është në rregull

5.2.1 Përfundimet e nxjerra nga pyetësi me qytetarë:

- Nga hulumtimi i realizuar 57% e qytetarëve janë shprehur se në lagjen e tyre nuk ka çezmë publike (JO), teksa 40% e tyre kanë treguar se ka çezmë publike (PO) dhe vetëm 3% e tyre kanë zgjedhur të përgjigjen me “Nuk e di”.
- Qytetarët të cilët janë përgjigjur me PO në pyetjen e parë, në vazhdimësi të pyetësorit janë pyetur se a kanë njohuri se sa e vjetër është çezmja e cila gjendet në lagjen tuaj; ku 6% e qytetarëve të anketuar kanë njohuri që çezmja në lagjen e tyre është e vjetër 100 vjet, 11% janë shprehur se çezma në lagjen e tyre është e vjetër mbi 100 vite, 16% kanë treguar se çezmat janë afërsisht 50 vite të vjetra dhe 67% e qytetarëve kanë treguar se nuk kanë informacione mbi vjetërsinë e çezmave në lagjet e tyre.
- Grupi i qytetarëve që janë përgjigjur me PO në pyetjen e parë po ashtu janë pyetur se a janë funksionale këto çezma në lagjet e tyre, ku 47% janë përgjigjur se PO janë funksionale, 42% kanë thënë se JO nuk janë funksionale, 7% kanë theksuar se janë funksionale po nuk i'u është ruajtur identiteti kulturor (arkitektura) dhe vetëm 4% e qytetarëve janë shprehur se këto çezma janë funksionale por jo gjatë gjithë vitit.
- Në vijim qytetarët e përgjigjur me JO në pyetjen e parë janë pyetur se a duhet të ketë çezme publike në lagjen ku ju banoni, e në këtë rast 92% e qytetarëve kanë thënë se po duhet të ketë, e vetëm 8% e tyre janë shprehur se nuk duhet të ketë çezme në lagjet e tyre.
- Krojet publike kanë qenë gjithmonë karakteristike për qytetin e Prizrenit, ata janë ndërtuar për qëllime të ndryshme, andaj është parë e arsyeshme që qytetarët të pyeten se sa shpesh i përdorin krojet në përditshmërinë e tyre. Në këtë rast 42% e qytetarëve janë shprehur se ndonjëherë i përdorin krojet, 32% kanë treguar se i përdorin shpesh herë, rrallë herë përdoren nga 21% e qytetarëve dhe vetëm 5% e tyre kanë thënë se nuk i përdorin asnjëherë.
- Sa i përket se a rrjedh uji gjatë gjithë vitit në çezmat e Prizrenit, 70% e qytetarëve e kanë pohuar këtë fakt, 22% të tjerë janë përgjigjur me nuk e di, 5% kanë thënë se JO nuk ka rrjedhje të ujit gjatë gjithë vitit dhe 3% e qytetarëve kanë theksuar se PO ka rrjedhje të ujit për disa çezma vetëm gjatë stinës së vjeshtës dhe të dimrit.
- Qytetarët në vazhdim janë pyetur se a kanë njohuri për ndonjë çezme publike jashtë lagjes ku ata jetojnë, në këtë rast 88% e qytetarëve kanë pohuar se kanë njohuri mbi disa çezma që ekzistojnë jashtë lagjes ku ata banojnë, dhe vetëm 12% e qytetarëve të anketuar janë shprehur se nuk kanë njohuri.

- Çezmat publike janë elemente shumë të rëndësishme të trashëgimisë kulturore, andaj qytetarët janë pyetur se a kanë njohuri për çezmat të cilat janë nën mbrojtje të shtetit, 45% e tyre kanë treguar se PO kanë njohuri, 25% kanë thënë se JO nuk kanë njohuri dhe 30% të tjerë janë shprehur se nuk e din.
 - Qytetarët e shprehur me PO në pyetjen e mësipërme në vazhdimësi janë pyetur se ku janë informuar në lidhje me çezmat e mbrojtura, e në këtë rast 8% e tyre kanë treguar se janë informuar nga librat, 7% janë informuar përmes gazetave, 8% e tyre kanë mësuar në shkollë dhe 77% e qytetarëve kanë mësuar përmes formave të tjera si media, rrjete sociale, publikime, etj.
- Ruajtja e identitetit të monumenteve të trashëgimisë kulturore është me shumë rëndësi për historinë, në lidhje me këtë qytetarët janë pyetur se a i'u është ruajtur gjendja fizike e çezmave publike të qytetit të Prizrenit. Në këtë rast 65% e qytetarëve janë shprehur se gjendja fizike e çezmave është ruajtur pjesërisht, 17% konsiderojnë se PO është ruajtur gjendja fizike e tyre, 11% mendojnë se JO nuk është ruajtur gjendja fizike e tyre dhe 7% e tyre nuk kanë informacione mbi këtë pyetje.
- 98% e qytetarëve mendojnë se duhet të shtohet më shumë kujdesi nga ana e qytetarëve për çezmat/krojet tradicionale të Prizrenit, teksa pjesa e mbetur (2%) e qytetarëve mendojnë qe jo nuk duhet të shtohet më shumë kujdes.
- Çezmat konsiderohen një element me shumë rëndësi i hapësirave publike të cilat duhet të jenë të qasshme për të gjithë qytetarët. E sa i përket qasshmërisë së krojeve për Personat me Aftësi të Kufizuara, krojet publike të Prizrenit nga 46% e qytetarëve konsiderohen deri diku të qasshme, nga 42% janë të paqasshme për PAK dhe vetëm 12% e qytetarëve këto kroje i konsiderojnë të qasshme për këtë grup të qytetarëve.
- 72% e qytetarëve si hapa drejt përmirësimit të gjendjes së krojeve publike të Prizrenit në të ardhmen i sugjerojnë funksionalizimin e krojeve jofunksionale, 77% e tyre hap të rëndësishëm e shohin restaurimin e çezmave jofunksionale dhe atyre të dëmtuara duke u'a ruajtur identitetin e tyre, ndërsa 57% e qytetarëve e shohin si hap shumë të rëndësishëm vendosjen e këtyre çezmave në listën e monumenteve të mbrojtura me ligj nga MKRS dhe vetëm 69% e qytetare mendojnë se duhet të vendosen tabela informuese me fakte mbi ato kroje.

- Qytetarët e anketuar në fund të pyetësorit po ashtu kanë ndarë me ne edhe disa çezme të cilat sipas tyre kanë ekzistuar më parë por tanimë nuk ekzistojnë (lista e më poshtme në disa raste ka emrat e vjetër të çezmave ose emrat e objekteve ose rrugëve se ku kanë ekzistuar ato në të kaluarën):

1. Çezma në Xhaminë Sinan Katip;
2. Pasha Çeshme;
3. Çezma në pikë takimin e rrugëve “Bujtinat dhe Pushkatarët” dhe në pikë takimin e rrugëve “Shuaip Spahiu” dhe “Pushkatarët”;
4. Burmali çezme;
5. Çezma e vjetër në lagjen “Luigj Gurakuqi”;
6. Çezmat me ngjyrë të gjelbër afër spitalit të Prizrenit;
7. Çezma e vjetër në rrugën “Fehmi Lladrovci”;
8. Tash Çezma;
9. Çezma e vjetër tek “Xhuma Xhamija”;
10. Guska Çezma në lagjen Jeni Mahallë;
11. Krojet e Begzades tek Hamami;
12. Kur çeshme afër varrezave;
13. Krojet afër Shtëpisë së Kulturës;
14. Krojet tek hyrja e Postës;
15. Krojet e Evrenus beut;
16. Kroi i Saraçhanes;
17. Çezma afër Kishës Katolike;
18. Keçeli çeshme;
19. Shanimahalle çezme.

6. HISTORIA E KROJEVE TË PRIZRENIT

Prizreni është qyteti më i pasur me ujë në Kosovë dhe bënë pjesë në grupin e qyteteve më të pasur me ujë në Ballkan. Që moti ai furnizohej me ujë në dy mënyra: me ujë të pastër burimor dhe nga lumi i Prizrenit, ujë ky i cili, me anë të vijave të shumta, shpërndahej nëpër oborre, kopshte, blloqe të banimit, madje edhe në ndërtesat në pjesën ultësinore të qytetit. Sheshet që shërbenin si vend pazare ishin të shtruar kryesisht me gurë dhe me kalldrëm, dhe të gjitha kishin krojet e tyre publike. Duke pasur parasysh faktin se Prizreni ka shumë burime që e përcjellin bregun e majtë të Lumit të Prizrenit, prej pjesës kur ai hyn në qytet e deri në pjesën qendrore, furnizimi me ujë të pijshëm ka qenë një elite. Tash për tash, për arsye objektive, nuk jemi në gjendje të flasim për furnizimin e Prizrenit me ujë prej themelimit të tij. Prandaj, do t'ia fillojmë prej periudhës osmane.

Prizreni kishte në të kaluarën më shumë ujësjellës dhe puse me ujin e të cilëve furnizohej deri në vitin 1871, kur Safet Pashë Rrotlla ndërtoi një ujësjellës të ri. Ujësjellësit e vjetër, çezmat dhe puset publike i ndërtonin mirëbërrësit e ndryshëm. Në ndonjërin prej atyre ujësjellësve lidheshin edhe krojet e rrugëve. Me 1573 Mehmet Pasha ndërtoi hamamin publik e furnizoi edhe me ujë prej burimit të afërm të Bunarllëkut. Ky ujësjellës ishte i gjatë rreth 300 metra. Prizreni i periudhës osmane, me një numër të madh banorësh, është dashur medoemos të ketë edhe stabilimentet e caktuara komunale për t'i përmbushur nevojat e përditshme ose të herëpashershme të popullsisë. Prej stabilimenteve komunale duhet përmendur ujësjellësin, krojet publike, puset, vijat e ujit, hamamet, kanalizimet, sahat-kullat, urat, ndriçimin rrugor, kalldrëmet dhe varrezat. Nga vakëfnameja e Suzi Qelebiut, e legalizuar me 1513, kuptojmë se Suziu, afër xhamisë së vet, ndërtoi edhe një krua. Për këtë krua, uji u soll prej "Bunarllëkut" që gjendej në Prizrenin e epërm. Ky ujësjellës edhe sot konsiderohet si ujësjellësi më i vjetër. Me ujë e furnizonte pjesën e majtë të ulët të qytetit dhe Çarshinë. Gjatësia e ujësjellësit ishte 2 km.

Pos kësaj, ky ujësjellës furnizonte edhe pjesën qendrore të qytetit. Prej ujësjellësit të Suzi Qelebiut dhe të Mehmet Pashës uji vinte në mëhallat e ulëta, kështu që pothuajse në çdo xhami, ndërtoheshin edhe krojet. Me 1585 Evranos-beu ndërtoi një krua në Tereqe Pazarin e dikurshëm (Tregun e drithit). Në pjesën më të madhe të rasteve, krojet nëpër xhamitë kanë pasur shumë cepa mesingu, gjë që varej prej sasisë së ujit. Ujësjellësi i Terzi-Mehmetit, u ndërtua me 1719 dhe furnizonte Terzimahallën dhe xhaminë. Me rastin e sjelljes së ujit në xhami gati përherë ndërtoheshin edhe disa kroje publike në disa pjesë të qytetit. Ndërtuesit e krojeve tentonin të jenë ato sa më origjinale, prandaj ngrehnin kroje të madhësive dhe formave të ndryshme. Mbi cepin e kroit, zakonisht vendosej mbishkrimi i bardhë i gdhendur me emrin e mirëbërësit që e ngriti, për ndër të kujt dhe për çfarë qëllimi. Të gjitha ujësjellësve, krojeve, shadërvaneve dhe puseve në Prizren u është kushtuar përherë kujdes i veçantë. Në të kaluarën këto objekte u ngritën kryesisht si përshpirtje të disa personave të shquar, qytetarëve të njohur, edhe të pasur.

Ky respekt ndaj krojeve u zhvillua veçanërisht për popullsinë që i përkasin fesë myslimane, pasi që uji ishte i domosdoshëm për larjen para kryerjes së riteve fetare, që mbaheshin pesë here në ditë. Prandaj, myslimanët i kanë kushtuar vëmendje të veçantë për ngritjen e krojeve. Këto i ndërtonin afër konakëve të veta, afër sarajeve, nëpër oborret e xhamive, nëpër rrugë, e veçanërisht nëpër udhëkryqe. Nëpër udhëkryqe rreth kroit publik, në të ashtuquajturin "tubim i vogël" ka qenë vendi për marrëveshje dhe për këmbime mendimesh kuvendi.

Abdyl-Fetah beu më 1845, me shpenzimet e veta, solli ujë prej pjesës së epërme të ujësjellësit të Cylenit deri në Varosh Mahallë dhe ngriti një krua. Derisa pjesa jugore e qytetit që furnizohej me ujë të Cylenit, pjesa qendrore furnizohej me Bunarllëk të Epërm. Sipas Salnames së Prizrenit nga viti 1874 në qytet kishte rreth 150 kroje ndërsa pak më vonë, 196 kroje.

Shumica e krojeve të ndërtuara në kohën e sundimit osman, sipas pamjes së vet, kishin veçori orientale. Në kroje janë ruajtur pllakat e mermerta me mbishkrimin e mirëbërësit në gjuhën osmane, por me alfabet arab. Për ngritjen e krojeve janë përdorur blloqe të bukura, të mëdhenj të gurëve të gdhendur. Për material lidhës është përdorur harosani (Ilaç i përgatitur prej gëlqeres dhe rërës). Këto kroje prej guri kishin edhe govata të gurit, që shërbenin për t'u dhënë ujë edhe kafshëve. Nuk kishin mbulesa të veçanta kulmore. Përfundonin me një ngritje të vogël e të pjerrësuar të kroit. Në disa kroje, me anë të vargonjve të vegjël e të imtë, lidheshin edhe gota të vogla prej bakri dhe të kallaisura, që shërbenin për të pirë më lehtë ujë në këto kroje. Për shkak të mungesës së ujit nëpër shtëpitë, ishte dukuri e zakonshme dalja e vajzave dhe e grave në kroje për të shpërlarë petkat e lara në shtëpi. Uji bartej prej kroit me anë të kënatave, shtambave dhe xhygmave të bakrit. Krojet ishin vende të përshtatshme për takimin e njohjen e vajzave me djemtë si dhe për afrimin e tyre. Shpesh ngjante që të ikën prej kroit vajza me të dashurin e vet. Me rastin e ndërtimit të Shtëpisë së Oficerëve kah fillimi i dhjetëvjetëshit të katërt të shekullit XX u ndërtua edhe ujësjellësi i tretë për këtë ndërtesë dhe për disa kroje publike (kroi i Lalës Gani Dukagjinit që gjendet përballë shtëpisë së tij, kroi pranë shtëpisë së Abdullah Zumaxhiut, kroi i çarshisë së Kaçanikut, kroi para shtëpisë së Ejyp Goranit në Tumbë, krojet jashtë mureve në të dy anët e Shtëpisë së Oficerëve dhe kroi para dy ndërtesave banesore të oficerëve).

Deri më 1954, Prizreni kishte të ashtu quajturin "Ujësjellësin turk" që kaptonte ujin prej burimeve të qytetit, nga Cyleni dhe ujërat e koritave dhe me anë të gypave prej qeramike, të ashtuquajtur "çynga", uji sillej deri te krojet e shumta të shadërvanet në qytet. Prej atyre krojeve, ditë e natë, rridhte uji i kthjelltë, e i ftohtë. Për mirëmbajtjen e tyre kujdeseshin çezmaxhinjtë. Ata rregullisht kontrollonin krojet e qytetit, duke bartur në strajcë druri të ashtuquajtur "tallash" thërrmijat e drurit të sharruar (bykun, hushkën, ashkën) të ashtu quajtur tallashir, përmes të cilit i mbyllnin plasaritjet e çyngave të ujësjellësit, të vendosur thellë në tokë dhe rritnin kufirin e vrushkujve të ujit.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Bazuar në hulumtimet e realizuara në literatura të ndryshme, pyetësorët me qytetarë dhe intervistat me historianë, arkeologë, zyrtarë të trashëgimisë kulturore dhe qytetarë të ndryshëm të Prizrenit rreth krojeve të Prizrenit, është vërejtur se krojet janë elemente me shumë rëndësi për trashëgiminë kulturore të Prizrenit e në të njëjtën kohë funksioni i tyre ishte shumë i rëndësishëm për qytetarët.

Për krojet të cilat gjenden në qendrën historike të Prizrenit, që kanë vlerë të madhe për trashëgiminë e qytetit duhet të ketë kujdes të veçantë.

Restaurimi dhe konservimi i përgjithshëm i krojeve ka një rëndësi të madhe për parandalimin e degradimit të tyre. Pastrimi dhe konservimi periodik i krojeve duhet të bëhet për arsye që gjendja e tyre të jetë gjithmonë e mirë për vizitorët. Shenjzimi i krojeve të cilat kanë rëndësi për trashëgiminë e qytetit, ku disa prej tyre janë edhe simbole të qytetit, duhet të vendosen tabelat informuese për arsye të informimit të qytetarëve/vizitorëve në lidhje me historinë dhe ndërtuesit e tyre.

E drejta e çdo qytetari është të ketë qasje në këto kroje dhe domosdoshmërisht është obligim që të mundësohet qasja edhe personave me aftësi të kufizuara, si në asetet e trashëgimisë, po ashtu edhe në pronën publike të qytetit. Rikthimi i krojeve të humbura në qytet ka një rëndësi të veçantë si për historinë, ashtu edhe për qytetarët e Prizrenit, për të rikthyer një histori materiale të qytetit.

Funksionalizimi i këtyre krojeve mund të ketë rëndësi të veçantë si për trashëgiminë, ashtu edhe për mjedisin. Funksionalizimi i krojeve publike ruan mjedisin pasi shmanget blerja e ujit në ambalazhe të plastikës. Kjo na tregon se mbrojtja e tyre, si nga institucionet lokale po ashtu edhe nga institucionet qendrore, është e domosdoshme.

Andaj për të përmirësuar gjendjen ekzistuese të krojeve dhe për të ruajtur identitetin e këtyre elementeve me rëndësi për trashëgiminë kulturore të Prizrenit rekomandohet që:

Të bëhet restaurimi dhe konservimi i përgjithshëm i të gjitha krojeve në mënyrë sa më detajizuar dhe ky konservim të vazhdohet në mënyrë periodike;

Të bëhet shenjzimi i krojeve me rëndësi (vendosja e tabelave informuese) duke pasur parasysh që të mos dëmtohet forma dhe struktura e tyre;

Gjatë restaurimeve, të shtohet kujdesi për të siguruar qasje në këto kroje për personat me aftësi të kufizuara;

Krojet të cilat për arsye të ndryshme infrastrukturore janë larguar duhet të kthehen në vendet e tyre të mëparshme;

Të bëhet vlerësimi po ashtu i disa krojeve dhe vendosja e tyre në listën e monumenteve të mbrojtura;

Të parandalohen dëmtimet e këtyre krojeve duke pasur kujdes të veçantë për mirëmbajtjen e tyre dhe mbikëqyrjen e tyre periodike.

FOTOGRAFI TË KROJEVE NDËR VITE



Fig. 17 Kompleksi i Mahallës së Marashit dhe kroi Topokli



Fig. 18 Kroi i Beledijes në sheshin e Lidhjes



Fig. 20 Kroi Binbashit



Fig. 19 Kroi te shtëpia e Shuaip Spahiut



Fig. 21 Kroi afër katedralës "Zoja Ndihmëtare"



Fig. 22 Kroi në oborin e hamamit të "Gazi Mehmed Pashës"




Fig. 23 Kroi te shtëpia e “Shuaip Spahiut”



Fig. 24 Tubimi afër kroit të Beledijes



Fig. 25 Kroi në lagjen Pantelia



Fig. 26 Kroi i Beledijes

REFERENCAT:

1. Databaza e trashëgimisë kulturore të Kosovës.
<https://dtk.rks-gov.net/Objekti?heritageld=1541>
<https://dtk.rks-gov.net/Objekti?heritageld=8779>
<https://dtk.rks-gov.net/Objekti?heritageld=1538>
<https://dtk.rks-gov.net/Objekti?heritageld=8778>
<https://dtk.rks-gov.net/Objekti?heritageld=9992>
<https://dtk.rks-gov.net/Objekti?heritageld=9487>
<https://dtk.rks-gov.net/Objekti?heritageld=1544>
2. Esat Haskuka – Analizat e funksioneve të Prizrenit gjatë shekujve: Fq 202, 203, 163, 69, 70, 305
3. Esat Haskuka – Ura Çarshia, Xhamia dhe Lagjja e Arastës: Fq 49
4. Muhamed Shukriu - Prizreni i lashtë: Fq 404 , 405 , 408 , 409
5. Arkivi i Hidroregjionit Jugore Prizren
6. Arkivi i Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore – Prizren

Të intervistuarit:

1. Jusuf Xhibo – arkitekt;
 2. Vesel Hoxhaj – arkeolog;
 3. Hyrmet Veliu – historian;
 4. Artnet Haskuka – arkitekthe;
 5. Besim Berisha – kryetar i Bashkësisë Islame;
 6. Elvane Imami – pensioniste;
 7. Ibadete Shehu – Bedra – mbesa e Musa Shehzades;
 8. Sedat Perolli – trashëgimtar i Kroit të familjes Perolli.
-

PËR EC

EC angazhohet për qëndrueshmëri ekonomike dhe qeverisje demokratike në nivel lokal (dhe rajonal) përmes mobilizimit të komunitetit, mbikëqyrjes së vendimmarrjes publike dhe partneritetit në zbatim të programeve dhe politikave zhvillimore.

Për përmbushjen e këtij misioni organizata zbaton projekte dhe nisma në kuadër të dy programeve kryesore: Qytete/Komuna Gjithëpërfshirëse dhe Zhvillim i Qëndrueshëm.

Ndërsa programi i tretë është ideuar si njësi mbështetëse për veprimin e organizatës dhe synon adresimin e tri sfidave të jashtme dhe të brendshme: 1. Vëllimin e pamjaftueshëm të dijes empirike në vend, përfshi të dhënat e besueshme statistikore, analizat e specializuara dhe mendimet profesionale, 2. Nevojën për konsolidimin e kapaciteteve të brendshme, veçanërisht në hulumtime, baza të të dhënave, analizë, menaxhim, zhvillim komunitar dhe ekspertizë sektoriale, dhe 3. Mungesën e qëndrueshmërisë financiare afatgjatë duke i diversifikuar burimet e të hyrave, me theks në ofrimin e shërbimeve për palët e treta.

Trekëndëshi konceptual që do të orientojë punën e organizatës në pesë vitet e ardhshme (2020 - 2024) ka këto elemente: 1. Gjithëpërfshirjen, 2. Qëndrueshmërinë, dhe 3. Dijen. EC beson se demokratizimi dhe zhvillimi i gjithëmbarshtëm shtetëror është proces që duhet planifikuar dhe ndërtuar nga posht lart. Në thelb të qeverisjes demokratike qëndron hapja dhe përfshirja e të gjithëve në marrjen e vendimeve që kanë për synim të mirën e përbashkët, ndërsa planifikimi zhvillimor kërkon shfrytëzim racional të burimeve territoriale, pa e kompromituar përdorshmërinë e tyre nga gjeneratat e ardhshme. Si demokracia ashtu edhe zhvillimi duhen ndërtuar mbi bazën e dijes së shëndoshë që garanton vendime dhe veprime të mençura dhe vizionare.

Vlerat kryesore të organizatës janë:

1. Paanshmëria - EC vepron në bazë të analizave të thukta dhe gjithëpërfshirëse dhe mënjanon veprimet e ngutshme dhe impulsive. EC synon të përkrahë dhe të shtyjë përpara alternativat të cilat në bazë të hulumtimit dalin të jenë më të përshtatshmet, pavarësisht nëse masa e shoqërisë nuk e përkrahin këtë opsion;

2. Aktivizmi - Anëtarët e EC do të jenë aktivistë të cilët angazhohen në baza të rregullta për të shtyrë përpara bashkëveprimin qytetar për të përmbushur misionin e organizatës;

3. Orientimi drejt rezultateve - Anëtarët e EC janë të orientuar për të arritur rezultate, ku përpjekja nuk i kënaq pritjet e organizatës në qoftë se nuk përfundon me rezultatet e pritura;

4. Komuniteti bazë e veprimit - EC do të jetë gjithnjë pranë komunitetit, duke mësuar nga qytetarët dhe duke ndërtuar konsensus për bashkëveprimin dhe formësimin e shoqërisë.

www.ecmandryshe.org